

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të pandehurit S. J, për shkak të veprës penale, ndryshimi i njëisorit të shërbimeve, nga neni 323 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr.1620/15, të datës 01.10.2015, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 23.03.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 29.03.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S. J, nga babai A dhe nëna, i lindur më datën ..në fshatin V, Komuna e Gj, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

ë s h t ë f a j t o r

S e p s e më 27 01.2015, në kohë të papërcaktuar, në shtëpinë e tij në fshatin V, Komuna e Gj, i pandehuri S.J si konsumator, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë për vete, pa autorizim ka shfrytëzuar energji elektrike, në atë mënyrë që njëhsoni elektrik me nr....., nga Komisioni i Qendrës së Kalibrimin në P, është konstatuar se për rreth qelqit nga ana e majt është vendosë shiriti i filmit dhe në brendi të njëhsonit është vërtetuar se ka pluhur të shioritit filmit, dhe disku i njëhsonit elektrik është penguar që të bëjë regjistrimin e sakt të enrgjisë elektrike të shpenzuar, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta e ka dëmtuar..., Distrikti në Gj, në shumën prej afro 90.70 Euro.

Me çka ka kryer veprën penale, ndryshimi i njëisorit të shërbimeve ,nga neni 323 i KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 ,73 , 74 , 75 dhe 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit, S. J, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 150 € (njëqind e pesdhjetë) Euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri, brenda afatit prej 2 (dy) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtojë shumën prej 20€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E dëmtuara, ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit S.J, për shkak të veprës penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve, nga neni 323 i KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit Leonora Shemsiu-Kadriu, si dhe i pandehuri S. J.

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri, e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi, i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve, nga neni 323 i KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurorja e shtetit Leonora Shemsiu- Kadriu në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar: gjatë seancës së sotme të shqyrtimit fillestar duke u bazuar në fakte se i pandehuri Sami Jahiu e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate, për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë, ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat tjera materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, fakte këto në bazë të cilave vërtetohet në tërësi se i njëjti ka kryer veprën penale ashtu siç është e përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, për çka mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Përkritazi me caktimin dhe llojin e dënimit i propozoj gjykatës që t'i merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese: para së gjithash pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, gjendjen e varfër ekonomike si dhe pendimin e tij, e cila që në fillim të shqyrtimit fillestar në këtë gjykatore, u pendua dhe premtoj se nuk do të kryen vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese: shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës.

I pandehuri S. J, në fjalën e vet përfundimtare, deklaroi: si në fillim të seancës, po edhe në fjalën përfundimtare e pranoi fajësinë për veprën me të cilën ngarkohem, pendohem për të njëjtën, i kërkoj falje të dëmtuarës ...dhe se kjo ka qenë hera e parë që kam rënë në kundërshtim me ligjin, kështu që i premtoj gjykatës se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptojë një dënim sa më të butë, për arsye se jam mbajtës i pesë anëtarëve të familjes dhe mezi mbijetoj me të ardhurat mujore në shumë prej 250 euro.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit.

Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri ..., në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, për veprën penale, ndryshimi i njësorit të shërbimeve, nga neni 323 i KPRK-së. Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin , gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se i pandehuri, i gjendjes së varfër ekonomike, kështu që shqiptimi i dënimit me gjobë dhe i pakushtëzuar do të ndikonte negativisht, gjegjësisht do të përkeqësonte gjendjen e vështirë ekonomike të tij, mbi këtë bazë të pandehurit i shqiptoi dënim të kushtëzuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar të dëmturës-..

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragraf 1, e në lidhje me nenin 450 paragraf 1 nën paragraf 2.6 të KPPRK-së.

E dëmtuara-..., konform neni 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pauroro-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lart gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i përgjithshëm.
P.nr. 1024/15 më datë 29.03.2017**

Sekretarja juridike,
Rafete Sylaj,d.v.

G j y q t a r i
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

